

Koncepti i orientimit në karrierë për Kosovë

Niveli i arsimit të mesëm të ulët

1.	Statusi i orientimit në karrierë në nivelin e arsimit të mesëm të ulët në Kosovë.....	3
	Projektet në Kosovë dhe rajon që kanë qenë të suksesshme në orientimin në karrierë	3
	Shërbimet e edukimit dhe orientimit në karrierë në shkolla	4
	Legjislacioni në arsimin parauniversitar.....	5
	Strategji që përfshijnë orientimin në karrierë	5
	Faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimeve për karrierë sipas dëshmive shkencore në Kosovë.....	6
2.	Përmbledhje e rezultateve të intervistave të kryera dhe fokus grupit.....	8
	Hyrje	8
	Gjendja aktuale e orientimit në karrierë në Kosovë	8
	Mbështetja aktuale e shkollës për orientimin në karrierë të nxënësve.....	8
	Mbështetja aktuale e familjes për të rinjtë për orientim në karrierë.....	9
	Sfidat dhe nevojat për mbështetje profesionale nga të gjitha palët.....	10
3.	KONKLUZIONE.....	13
4.	Koncepti i orientimit në karrierë bazuar në "Modelin e Pesë Hapave"	15
	Përmbledhje	16
	Hapat e veçantë të "Modelit me Pesë Hapa".....	17
	Numri i orëve dhe lëndët e përshtatshme.....	19
5.	Prioriteti 1.: Përshtatja e "Modelit ekzistues me Pesë Hapa"	22
6.	Prioriteti 2: Forcimi i sistemit arsimor për orientim në karrierë	25
7.	Prioriteti 3: Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e orientimit në karrierë dhe faktorëve që sigurojnë qëndrueshmëri.....	28
8.	Prioriteti 4: Korniza ligjore	33
9.	Super, D., (1990). Një qasje e jetëgjatësisë, mundësisë jetësore për zhvillimin e karrierës. In Allison, Ch. & Cossette, M., (2007). Tre teori të zhvillimit të karrierës dhe zgjedhjes. Edmonds Community College: 20000 68 Avenue West, Lynnwood, WA 98036.....	37

Projektet në Kosovë dhe rajon që kanë qenë të suksesshme në orientimin në karrierë

Ekziston një prani e madhe e projekteve të orientimit në karrierë nga anë të ndryshme, MASHTI dhe komuniteti i donatorëve në Kosovë, sa i përket orientimit në karrierë dhe zhvillimit të fuqisë punëtore. Shumë ndërhyrje dhe projekte të orientimit në karrierë, të cilat tani janë pjesë e sistemit arsimor, janë prezantuar dhe mbështetur nga komuniteti i donatorëve. Më poshtë janë informacionet nga niveli qendror dhe organizatat donatore që luajnë një rol të rëndësishëm në kontekstin e edukimit dhe orientimit në karrierë të Kosovës: Bashkimi Evropian (BE), GIZ Kosova, Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC), USAID Kosovë, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Solidar Suisse, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Agjencia për Zhvillim e Luksemburgut (LuxDEV), etj.

Aktualisht, çështjet që kanë të bëjnë me ofrimin e orientimeve për karrierë në Kosovë janë të rregulluara me akte të shumta ligjore dhe nënligjore që lidhen me fusha të ndryshme si: punësimi, arsimi dhe rinia. Ligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve rregullon funksionimin e sektorëve rinorë, përcakton përgjegjësitë e institucioneve si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror në lidhje me organizatat rinore dhe ofron një kornizë ligjore për punën vullnetare dhe edukimin joformal.

Shërbimet e edukimit dhe orientimit në karrierë në Kosovë janë themeluar që nga viti 2002, kryesisht përmes mbështetjes së projektit të BE/KosVET I (2002-2004), mbështetjes së ILO dhe ETF. Fokusi fillestar u përqendrua në ofrimin e këshillimit nga këshilltarët e punësimit dhe koordinatorët e trajnimit profesional për të ndihmuar në vendimmarrje punëkërkesit dhe të papunët, ndërsa diskutimet për një sistem orientimi të bazuar në shkollë u nisën me prezantimin e një "viti orientimi për klasën e 9-të" në shtator 2002. Viti i parë i projektit u fokusua në zhvillimin e një strategjie 10-vjeçare për edukimin dhe orientimin në karrierë (EOK) në vitin 2005. I iniciuar nga MASHTI, i mbështetur edhe nga UNICEF-i, projekti synonte të përfshinte EOK në pilotimin e "aftësive për jetën" si lëndë e klasës së 8-të në rreth 30 shkolla.

Në vitin 2011 korniza e zhvilluar e kurrikulës u bazua në kompetencat dhe rezultatet e pritura. Në Kurrikulën e re të Kosovës janë 7 fusha kurrikulare. Fusha kurrikulare "jeta dhe puna" ka të bëjë me zhvillimin e kompetencave të jetës, punës dhe mjedisit dhe rezultati përfundimtar është formimi i një personi produktiv, kontribuues. Një nga konceptet e fushës 'jeta dhe puna' është edukimi dhe orientimi në karrierë. (Hyrje në Konceptet Bazë, Punësimi

dhe Profesionit). Koncepti i edukimit dhe orientimit në karrierë është i detyrueshëm së bashku me konceptet e tjera të fushëveprimit të fushës “Jeta dhe puna”, vetëm në gjysmë vjetorin e dytë dhe parashikohet të zhvillohet në të gjitha nivelet e arsimit para universitar. Gjithashtu te fusha kurrikulare Shoqëria dhe Mjedisit është paraparë që në nivelin e arsimit të mesëm të ultë, nxënësit të ndihmohen për të zhvilluar e të përfunduar më tej njohuritë e tyre duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe orientim në karrierë. Pjesa e orientimit të karrierës në modulin "Jeta dhe puna" bazohet në modelin austriak të përshtatur "Pesë hapat" dhe parashikon punën me nxënësit në një formë të orientuar drejt veprimit. GIZ mbështet Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në arritjen e objektivave të saj lidhur me fushën kurrikulare Jeta dhe Puna, Programi i GIZ CDBE ka bashkëpunuar me KCDF-në në themelimin e Klubeve të Karrierës në 20 shkolla kampione, përmes aktivitetit të tyre të projektit “Qasja për zhvillimin e integruar të shkollave”. Klubet e karrierës janë nisma të nxitura nga nxënësit që përfshijnë aktivitete dhe projekte jashtë - kurrikulare dhe kurrikulare në shkollat e mesme të ulëta. Ato janë themeluar në kuadër të shkollës dhe menaxhohen nga 15 nxënës të klasave VII, VIII dhe IX dhe një mësues mentor, ndërsa mbështeten nga menaxhmenti i shkollës.

Mbështetur nga Projekti Rritja e Punësimit të Rinjve - EYE dhe zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Zhvillimin e Karrierës - KCDF u zhvillua doracak në emër të projektit "Mbështetja e nxënësve të klasës së IX për një zgjedhje të informuar të karrierës". Ky manual është përgatitur për stafin e Qendrës së Karrierës, për të mbështetur koordinimin e tyre me mësuesin e fushës e “Jeta dhe Puna” në realizimin e aktiviteteve të edukimit për karrierë me nxënësit e klasave të IX-ta. Projekti synon gjithashtu rritjen e angazhimit të prindërve, si faktorë kyç të procesit të orientimit në karrierë të fëmijëve të tyre. Kjo do t'u mundësojë prindërve të bëhen anëtarë aktivë të trekëndëshit mësues-prindër-nxënës.

Shërbimet e edukimit dhe orientimit në karrierë në shkolla

Një nismë e MASHTI-t në vitin 2014 ishte rritja e aftësive të mësuesin e nxënësve për të ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësisë së nxënësve për një vendim të informuar për karrierën. Me këtë MASHTI i ka ndarë një numër të konsiderueshëm orëve mësimore edukimit për karrierë përmes futjes së fushës kurrikulare Jeta dhe Puna. Ajo që filloi si një pilot projekt, Edukimi në Karrierë iu caktua si modul i kësaj fushe kurrikulare përafërsisht 320 shkollave publike të mesme të ulëta dhe të larta. Mësuesit e TIK-ut në këto shkolla përdorin 1/3 e kohës së tyre për ofrimin e TIK-ut, 1/3 për Ndërmarrësin dhe 1/3 për Edukimin në Karrierë. Qëllimi i Ministrisë ishte që gradualisht të zgjerohej ky pilot projekt në të gjitha shkollat publike, në varësi të rezultateve të fazës pilot.

Për të mbështetur ofrimin e orientimit për karrierë në të gjithë nivelin e arsimit para universitar, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) po përdor platformën online Busulla.com. Kjo platformë shërben si një mjet për mësimdhënësit për të arritur objektivat e fushës kurrikulare "Jeta dhe puna". Mësimdhënësit e kësaj fushe kurrikulare janë trajnuar për përdorimin e Busulla-s. Procesi i të mësuarit përfshin pesë faza, duke përfshirë vetë njohjen, eksplorimin e tregut të punës, identifikimin e institucioneve arsimore / ofruesve të trajnimit dhe identifikimin e mundësive të punës dhe praktikës. MASHTI ka autorizuar Drejtoritë Komunale të Arsimit-DKA-të që të vlerësojnë nëse duhet të autorizojnë dhe investojnë në shfrytëzimin e platformës Busulla-s për shkollat e tyre. Busulla është miratuar përmes një memorandum mirëkuptimi nga shumica e komunave, por qëndrueshmëria financiare nuk është siguruar, sepse komunat nuk kanë treguar konsistencë në përmbushjen e kësaj marrëveshjeje të rregulluar me memorandum.

Fazat e përmendura korrespondojnë me pesë fazat e modelit të zhvilluar në këtë dokument. Ky fakt e bën më të lehtë për profesionistët që të vazhdojnë orientimin në karrierë me një model të njohur duke përdorur metoda shtesë krahas mësimëve të TIK-ut.

Legjislacioni në arsimin para universitar

Ligji Nr. 04/L-032 për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës mbulon arsimin para fillor, fillor, të mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë (gjimnazin), ndërsa arsimi dhe aftësimi profesional (AAP) rregullohet me legjislacion të veçantë, d.m.th. Ligji Nr. 04/L-138 për AAP-në. Asnjëri prej këtyre ligjeve nuk paraqet pengesë për ofrimin e edukimit dhe orientimit në karrierë. Përveç kësaj, sipas Ligjit për AAP-në, orientimi dhe këshillimi në karrierë është i detyrueshëm për institucionet e AAP-së. Ligji për AAP-në në nenin 6, paragrafin 3.3 parashikon që orientimi dhe këshillimi në karrierë duhet të jenë pjesë përbërëse e të gjitha programeve të ofruara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional. Ndërsa Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 01/2014 i cili tani është i aplikueshëm për organizimin dhe planifikimin e procesit arsimor në AAP, i obligon institucionet e AAP-së që të dërgojnë nxënësit në praktikë, të organizojnë ditë me dyer të hapura për nxënësit e klasës së nëntë (9) dhe të organizojnë "Ditën e Vajzave", ku për një ditë vajzat shkojnë në praktikë, një profesion që konsiderohet si profesion i mashkullit.

Strategjitë që përfshijnë orientimin në karrierë

Aktualisht, financimi për shërbimet e orientimit në karrierë është pjesë e financimit të përgjithshëm. Në këtë moment nuk ka një strategji specifike të fokusuar në orientimin në

karrierë. Orientimi në karrierë është pjesë e disa planeve strategjike të zhvilluara në nivel kombëtar. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021 përcakton “Lidhjen më të mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës” si një nga prioritetet.

*Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (2017-2021)*¹ i cili ndër të tjera fokusohet në ofrimin e orientimit dhe këshillimit në karrierë dhe sigurimin e zhvillimit të mëtutjeshëm të Qendrave të Kompetencës për aftësim profesional. Përkundër kësaj, në Vlerësimin e Zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021² thuhet se ka vend për përmirësime, veçanërisht në institucionalizimin dhe shtrirjen e iniciativave në të gjitha komunat.

Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjve 2018-2020 synon rritjen e qasjes së të rinjve në tregun e punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit (këshillim, orientim në karrierë, programe praktike, ndërmjetësim punësimi, etj.) dhe masa aktive punësimi si dhe harmonizimit të arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës dhe ofrimit të shërbimit të orientimit dhe këshillimit në karrierë.

Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale 2018-2022 propozon masa për përmirësimin e shërbimeve publike të punësimit, duke përfshirë orientimin dhe këshillimin në karrierë.

Strategjia për të rinjtë 2019-2023, një nga objektivat e strategjisë është promovimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve për orientimin në karrierë dhe tregun adekuat të punës.

Faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimeve për karrierë sipas dëshmive shkencore në Kosovë

- Bazuar në teoritë e zhvillimit të karrierës, vetë-koncepti dhe pjekuria e karrierës janë faktorë të rëndësishëm për vendimmarrje të suksesshme në karrierë (Super, 1990). Këto dy konstrukione të karrierës, me të gjitha dimensionet e tyre, rezultojnë të jenë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin dhe procesin e vendimmarrjes së të rinjve kosovarë (Jemini-Gashi, 2021).
- Bazuar në teorinë sociale-kognitive mbi karrierën, zhvillimi i karrierës është një kombinim i faktorëve personal, njohës dhe kontekstual, një kombinim që ndikon në formimin e interesave në karrierë, zhvillimin e qëllimeve, si dhe në performancën (Constantine, Wallace dhe Kindaichi, 2005).

¹Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017-2021, Korrik 2016

²Qendra Arsimore e Kosovës. Vlerësimi i Zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017 – 2021, maj 2021. Një kopje e tij gjendet në “Dosjen e orientimit në karrierë në Kosovë”.

- Statusi i karrierës së adoleshentëve lidhet pozitivisht me konstruktet njohëse të modelit të zgjedhjes, mbështetjen sociale dhe faktorët kontekstual. Vetë-efikasiteti i karrierës, rezultatet e pritura dhe qëllimet e karrierës janë faktorë parashikues për statusin e vendimit për karrierë.
- Mbështetja sociale duke përfshirë mbështetjen e familjes, shkollës dhe bashkëmoshatarëve kanë korrelacione të rëndësishme pozitive me vendimmarrjen në karrierë dhe sigurinë (Jemini - Gashi, 2021). Roli i shkollës, mësimdhënësve dhe profesionistëve, është parë të jetë i një rëndësie të veçantë në studimet e kryera në Kosovë (Jemini - Gashi, 2014). Të rinjtë që raportuan mbështetje nga mësimdhënësit dhe psikologët e pedagogët e shkollës, sigurisht që ishin më të sigurt për vendimin e tyre për karrierën (Jemini - Gashi, Hyseni Duraku & Kelmendi, 2019), ndërsa të rinjve që u mungonte kjo mbështetje, kanë raportuar nivele të larta të pavendosmërisë në karrierë (Jemini - Gashi, 2013a; Jemini – Gashi, 2013b; Jemini-Gashi, 2021, Jemini – Gashi & Kadriu, 2022).
- Sipas teorisë person-mjedis të John Holland, individët zgjedhin ato profesione që janë në përputhje me personalitetin e tyre. Një zgjedhje e suksesshme profesionale është kur sigurohet përshatja midis personalitetit dhe mjedisit të punës (Holland, 1997). Rëndësia e kongruencës mes personalitetit dhe profesionit të zgjedhur konfirmohet edhe në kontestin kosovar. Të rinjtë me një kongruencë të tillë, kanë qenë më të përgatitur dhe më të sigurt për karrierën e tyre (Jemini – Gashi & Berxulli, 2017; Jemini - Gashi, 2021).

Hyrje

Ky seksion do të bazohet në temat kryesore dhe do të paraqesë gjetjet që dolën nga procesi i intervistave dhe analiza e mëpasshme e të dhënave ose analiza tematike. Janë realizuar gjithsej njëmbëdhjetë intervista me nxënës, mësimdhënës të TIK-ut, psikologë shkollor, këshilltarë për karrierë, anëtarë të klubeve të karrierës, prindër, përfaqësues nga MASHTI dhe DKA si dhe një fokus grup me përfaqësues të donatorëve. Temat kryesore që u shfaqën pas analizës së transkriptit ishin:

- (a) Gjendja aktuale e orientimit në karrierë në Kosovë;
- (b) Mbështetja aktuale e shkollës për orientimin e nxënësve në karrierë;
- (c) Mbështetja aktuale e familjes për të rinjtë për orientim në karrierë;
- (d) Sfidat dhe nevojat për mbështetje profesionale nga të gjitha palët;
- (e) Faktorët/palët e mundshme mbështetëse për orientimin në karrierë të të rinjve

Në vazhdim të këtij seksioni janë paraqitur konkluzionet e bazuara në gjetje.

Gjendja aktuale e orientimit në karrierë në Kosovë

Gjatë analizës tematike të intervistave, një nga temat që u theksua ka të bëjë me gjendjen aktuale të orientimit në karrierë. Gjendja aktuale e Orientimit në Karrierë doli që kishte shumë hapësirë për përmirësim. Kjo theksohet nga këndvështrimi i të gjitha sistemeve mbështetëse: përfaqësues nga MASHTI, DKA, psikologë shkollor, mësimdhënës, donatorë, këshilltarë për karrierë, prindër dhe nxënës.

Përkundër shumë përpjekjeve dhe punës që është bërë në lidhje me komponentin e orientimit në karrierë në Kosovë, rezultatet e intervistave tregojnë se të rinjtë kosovarë nuk marrin mbështetjen e duhur për planifikimin, orientimin dhe marrjen e vendimeve të karrierës.

Mbështetja aktuale e shkollës për orientimin në karrierë të nxënësve

Gjetjet kanë treguar se faktori më i rëndësishëm në procesin e planifikimit, orientimit dhe vendimmarrjes për karrierën është shkolla. Ky institucion arsimor, së bashku me arteret/palët e tij, luajnë një rol themelor në formësimin e interesave të nxënësve. Nga intervistat me nxënësit e klasës së nëntë u theksua roli i veçantë i psikologut shkollor në procesin e orientimit në karrierë.

Shkollat nuk u perceptuan si një burim i mbështetjes së plotë të nevojshme nga të gjithë pjesëmarrësit në lidhje me orientimin dhe vendimmarrjen në karrierë. Mbështetja nga shkolla

përmes kurrikulës, procesit mësimor, psikologëve të shkollës dhe aktiviteteve shkollore janë të pamjaftueshme, pavarësisht vullnetit të të gjithë artereve/palëve të shkollës. Numri i orëve për OK është i pamjaftueshëm për realizimin e lëndës bazë, TIK dhe komponenti i karrierës brenda kësaj dëmton realizimin korrekt të të dy përmbajtjeve duke rezultuar në dështimin e arritjes së objektivave, si për pjesën e TIK-ut ashtu edhe për pjesën orientuese për karrierë, ku ndër të tjera mungon literatura. Orët e mësimi janë të pamjaftueshme, ka mungesë të literaturës adekuate, mungesë të kuptimit të terminologjisë dhe konceptit të edukimit në karrierë, mësimdhënie të papërgatitur lidhur me procesin e planifikimit edukimit dhe orientimit në karrierë. Gjetjet nënvizojnë rëndësinë e Busulla-s në këtë komponent, megjithëse nevoja për mbështetje shtesë në lidhje me përmbajtjen, përdorimin dhe interpretimin është evidente. Rezultati në përfundim të testit me një profesion të rekomanduar për nxënësit kërkon vëmendje profesionale dhe rivlerësim të platformës.

Mungesa e mbështetjes është parë edhe në rolin e psikologëve të shkollës. Gjetjet tregojnë se rolet e shumta të psikologëve të shkollës dhe përcaktimi i paqartë i detyrave të tyre konsiderohen si sfidë apo vështirësi e veçantë në realizimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve që lidhen me orientimin e nxënësve në karrierë. Nga çdo këndvështrim, orientimi në karrierë konsiston në njohjen e profesioneve dhe përgatitjen për punë, gjetje që na tregojnë se "vetë-njohja" si hapi i parë drejt planifikimit dhe orientimit në karrierë rezulton të jetë sfida kryesore, kryesisht e panjohur nga përfaqësuesit e ndryshëm të grupeve të synuara të intervistuar. Me fjalë të tjera, përmes orëve të shkollës, nxënësit kanë mundësi të njohin veten, të njohin botën e profesioneve, të kuptojnë rëndësinë e përshtatjes së tyre me profesionet, të njohin drejtimet që kanë shkollat e mesme të larta, të njohin tregun e punës, dhe si rrjedhojë, mbeten me sfidat dhe vështirësitë e një vendimmarrjeje të duhur në karrierë për ta.

Mbështetja aktuale e familjes për të rinjtë për orientim në karrierë

Gjatë analizës tematike të intervistave, një nga temat që është vënë në pah është nëse të rinjtë po arrijnë të marrin mbështetjen e mjaftueshme nga familja. Familja shihet të jetë faktori më mbështetës në lidhje me orientimin në karrierë. Të rinjtë raportuan diskutime me prindërit rreth profesioneve të tyre, informacion mbi ato profesione dhe mbështetje për përcaktimin e preferencave. Nga ana tjetër, prindërit dhe fëmijët theksojnë mbështetjen e pamjaftueshme në drejtim të orientimit në karrierë, dhe kjo si pasojë e mungesës së informacionit për mbështetjen e duhur dhe të drejtë që duhet bërë për të rinjtë.

Sfidat dhe nevojat për mbështetje profesionale nga të gjitha palët

Sfidat dhe nevojat e nxënësve për shërbime të orientimit në karrierë në shkolla

Bazuar në gjetjet, nxënësit kanë nevojë për një program të strukturuar, të planifikuar mirë dhe formal të orientimit në karrierë për të rinjtë. Për më tepër, ata identifikuan dy lloje nevojash që lidhen me orientimin dhe vendimmarrjen në karrierë: së pari, nevojën për informacion dhe orientim. Sipas nxënësve, mësuesit dhe psikologët duhet t'i informojnë ata si dhe t'i lehtësojnë dhe t'i udhëheqin në procesin e vendimmarrjes për karrierën. Mësimdhënësit në koordinim me akterët relevant duhet t'i paraqesin lëndët e tyre në mënyrë konkrete përmes mësimeve në mënyrë që qëllimi dhe përmbajtja e tyre të jenë mjaft të qarta. Një lëndë obligative e orientimit në karrierë do t'i ndihmonte shumë nxënësit. Së dyti, nevoja për punë praktike dhe ushtrime theksohet nga gjetjet. Shkollat si institucione arsimore duhet të ofrojnë mundësi për praktika dhe ushtrime në fusha të ndryshme.

Sfidat dhe nevojat e mësimdhënësve për orientimin në karrierë të nxënësve

Gjetjet nga analiza tematike e intervistave tregojnë se mësimdhënësit kanë nevojë të madhe për mbështetje profesionale, në mënyrë që të ndihmojnë nxënësit në këtë drejtim. Sfidat e tyre kryesore lidhen me përgatitjen e pamjaftueshme profesionale për edukimin dhe orientim në karrierë, pamundësi për të integruar komponentin e karrierës brenda lëndës së TIK-ut dhe mungesën e literaturës adekuate. Mbi këtë bazë, gjetjet tregojnë se mësimdhënësit kanë nevojë për përgatitje profesionale, trajnime dhe seminare për të kuptuar më mirë rolin dhe mënyrat e mbështetjes për nxënësit. Për të realizuar këtë detyrë, ata kanë një nevojë të madhe për një figurë/strukturë shkollore i/e cila do të koordinonte dhe orientonte të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me orientimin në karriere brenda shkollës. Një numër i konsiderueshëm mësimdhënësish të lëndës 'Jeta dhe puna' të klasës së nëntë nuk e perceptojnë orientimin në karrierë si pjesë të lëndës të tyre. Fokusi i tyre kryesor është tek Teknologjia dhe TIK-u. Këta mësimdhënës ankohen se fondi i orëve në kuadër të lëndës TIK nuk mjafton as për aktivitete këshillimi dhe orientimi në karrierë. Nga këndvështrimi i mësimdhënësve të TIK-ut, kuptohet se është e nevojshme një mbështetje shtesë profesionale në lidhje me përmbajtjen në edukim, orientim dhe këshillim për karrierë.

Sfidat dhe nevojat e psikologëve të shkollës për orientimin në karrierë të nxënësve

Sfidat kryesore të psikologëve shkollorë në lidhje me orientimin në karrierë të nxënësve janë ngarkesa e punës në raport me numrin e madh të nxënësve dhe mungesa e përcaktimit

të qartë të rolit të tyre, mungesa e kompetencës profesionale dhe profilizimi për procesin e orientimit në karrierë të nxënësve, mungesa e literaturës që lidhet me procesin e vendimmarrjes për karrierën në përgjithësi. Gjetjet nga këndvështrimi i psikologut shkollor tregojnë një nevojë thelbësore mbështetëse për ta. Një tjetër nevojë shumë e rëndësishme nga këndvështrimi i psikologut të shkollës ka rezultuar të jetë siguri i aftësive dhe instrumenteve matëse për të vlerësuar ndikimin që mund të ketë pasur duke ofruar shërbime të ndryshme që u ofrohen nxënësve në drejtim të orientimit në karrierë.

Sfidat dhe nevojat e këshilltarëve të karrierës³ për orientimin në karrierë

Gjetjet nga intervistat nxjerrin në pah edhe sfidat e këshilltarëve të karrierës, lidhur me mungesën e mbështetjes institucionale, për praktikën dhe qasjen në punësim. Një kërkesë apo nevojë madhore për këshilltarët e karrierës, konsiston në standardizimin e pozitës së tyre, kriteret dhe përshkrimi i profilit të tyre, si dhe trajnime të ndryshme me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të tyre për kryerjen e këtij funksioni. Përmes qartësimit të pozitës së tyre, rolit dhe mbështetjes përmes trajnimeve dhe ofrimit të materialeve, këshilltarët e karrierës do të mund të fitonin njohuri dhe kompetencë më të madhe në ofrimin e shërbimeve të tyre. Trajnime të planifikuara dhe unifikuara nga institucionet të cilat fillimisht do të fokusoheshin në procesin e vetë-njohjes dhe të vetëvlerësimit, procesin e njohjes së profesioneve, apo procesin e studimit të informacionit brenda dhe jashtë vendit, mbi të gjitha informacionet dhe udhëzimet që lidhen me tregun e punës, konsiderohen si shumë të nevojshme.

Sfidat dhe nevojat e Drejtorisë Komunale të Arsimit për orientimin në karrierë të nxënësve

Përkundër gjithë punës që po kryen DKA, konkretisht Qendra e Karrierës, padyshim që ka nevoja dhe kërkesa të ndryshme për të arritur një standard të dëshiruar të punës. Sipas gjetjeve nga intervista me përfaqësuesin e DKA-së, kjo ndarje thekson vazhdimisht nevojën për të pasur individë të profilizuar për orientim në karrierë.

3 Këshilltarët e karrierës në këtë rast nënkuptohen grup i këshilltarëve, të cilët janë trajnuar në shkallen e 5 nga programi Pearson, por të cilët ende nuk e ushtrojnë profesionin e tyre.

Sfidat dhe nevojat e MASHTI-t dhe donatorëve për orientimin në karrierë të nxënësve

Gjetjet nga analiza tematike e intervistave dhe fokus grupeve nxjerrin në pah disa sfida për orientimin në karrierë të nxënësve edhe nga këndvështrimi i zyrtarëve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe donatorëve kontribuues për orientimin në karrierë të të rinjve në Kosovë. Sipas pjesëmarrësve, pavarësisht punës dhe përkushtimit të madh që është bërë nga të gjithë akterët/palët, orientimi në karrierë perceptohet si një ngecje e shoqëruar me disa elementë kyç: sfidat e arritjes së komponentit të karrierës brenda lëndës së TIK, mungesa e kompetencës së mësimdhënësve të kësaj fushe për orientimin në karrierë, mos koordinimi i të gjithë artereve/palëve në realizimin e duhur të komponentit të karrierës, mospërputhja e kontributeve të marra nga projekte të shumta, paqartësia e rolit që kanë të gjithë akterët/palët mbështetëse për orientimin në karrierë të nxënësve etj.

Faktorët/palët e mundshme mbështetëse për orientimin në karrierë të të rinjve

Pavarësisht vështirësive dhe sfidave të theksuara nga të gjithë akterët për krijimin e kushteve më të favorshme brenda shkollave, gjetjet tregojnë se në procesin e orientimit në karrierë nxënësit mund të mbështeten nga disa faktorë/palë. Mbështetja nga prindërit ose anëtarët e familjes konsiderohet si një faktor kyç në mënyrën se si fillon dhe përfundon ky koncept. Faktorë/palë të tjerë të rëndësishëm sipas gjetjeve janë edhe bashkëmoshatarët. Pavarësisht sfidave dhe mungesës së shërbimeve adekuate për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, janë identifikuar disa faktorë/palë të rëndësishme që shkolla do të mund t'i adresojë në procesin e orientimit në karrierë. Për sa i përket mbështetjes së nevojshme për nxënësit në procese të ndryshme të orientimit në karrierë, gjetjet tregojnë se nxënësit kanë nevojë për mbështetje në procesin e vetë-njohjes dhe vetëvlerësimit, në procesin e njohjes së profesioneve dhe drejtimeve për arsimin e mesëm të lartë, me qëllim të marrjes së vendimit të drejtë për karrierë. Gjithashtu, rëndësi të veçantë tregohet se kanë aktivitetet jashtëshkollore dhe praktikat e ndryshme. Si faktorë/palë me ndikim, DKA vlerëson sistemin e familjes dhe shoqërisë, të cilat ndihmojnë në formësimin e qëndrimeve dhe vendimeve të nxënësve.

KONKLUZIONE

- Gjendja aktuale e orientimit në karrierë të nxënësve në Kosovë ka shumë hapësirë për përmirësim.
- Nxënësit e shkollave të mesme të ulëta hasin vështirësi gjatë procesit të planifikimit të karrierës së tyre.
- Nxënësit raportojnë mungesë të mbështetjes nga sistemi arsimor.
- Nxënësit nuk arrijnë të marrin informacion përmes mësimave që do t'i ndihmonin ata të planifikonin dhe orientonin karrierën e tyre.
- Nxënësve u nevojiten informacione për procesin e vetë-njohjes, njohurisë së profesioneve, njohurive të drejtimeve të shkollës së mesme, njohurive të tregut të punës.
- Nxënësit nuk arrijnë të marrin mbështetje nga psikologët e shkollës dhe stafit tjetër mbështetës në shkollë në lidhje me orientimin e tyre në karrierë.
- Nxënësit mbështeten kryesisht nga familjet e tyre, shoqëria dhe media, megjithëse format e mbështetjes nuk janë gjithmonë të drejta dhe të mjaftueshme.
- Nxënësit kanë nevojë për përfshirje më të mirë në klubet e karrierës si dhe në ciklet e mesme të larta duke siguruar koordinim.
- Mungon një akter/strukturë qendrore për ofrimin, koordinimin e aktiviteteve shkollore për orientimin në karrierë
- Mungon pozita e këshilltarit të karrierës në shkollë e cila do të mbulonte orientimin në karrierë.
- Mësimdhënësit ndihen të papërgatitur mjaftueshëm për të mbuluar edukimin dhe orientimin në karrierë të nxënësve.
- Mësimdhënësit kanë nevojë për mbështetje të unifikuar profesionale, literaturë dhe libra adekuat në lidhje me orientimin në karrierë.
- Mësimdhënësit e shohin si pengesë futjen e një komponenti të karrierës vetëm brenda lëndës së TIK-ut.
- Psikologët e shkollës ndihen të pamjaftueshëm me përvojë dhe kanë nevojë për mbështetje profesionale në lidhje me orientimin dhe këshillimin në karrierë.
- Psikologët e shkollës theksuan nevojën për instrumente matëse për vlerësimin e nxënësve dhe këshillimin e karrierës.
- Këshilltarët e karrierës shprehin mungesën e punës praktike dhe qasjes për të punuar me nxënësit.
- Këshilltarët e karrierës shprehin nevojën për mbështetje profesionale në lidhje me orientimin në karrierë të nxënësve.
- Prindërit shfaqin dilema në mënyrat për të mbështetur fëmijët e tyre.

- Prindërit shprehin nevojën për mbështetje profesionale për mënyrat më të mira që mund të mbështesin fëmijët e tyre.
- Përfaqësues të institucioneve shprehin nevojën për përmirësimin e funksionimit dhe koordinimit të komponentit të karrierës nga të gjithë akterët/palët potenciale.
- Përfaqësues të institucioneve theksojnë nevojën integritit të këshilltarit në karrierë në strukturën shkollore me qëllim të ofrimit të programeve të qëndrueshme për orientimin e nxënësve në karrierë.
- Të gjitha palët, pjesëmarrësit e intervistave dhe fokus grupet, theksojnë nevojën e madhe për të ndërtuar një koncept i cili përfshin në mënyrë të drejtë të gjithë akterët/palët dhe shtrin qartë komponentin e karrierës në sistemin arsimor për nxënësit e klasave 6-9. Është e rëndësishme të ndërtohet një koncept që siguron qëndrueshmërinë e mbështetjes së vazhdueshme për orientimin e nxënësve në karrierë.
- Ekziston nevoja për të hartuar instrumente matëse për vlerësim, këshillim dhe orientim në karrierë dhe udhëzues e manuale mbështetëse për t'iu ndihmuar nxënësve në marrjen e vendimit për karrierë.
- Përditësimi i platformës Busulla është i nevojshëm në dy pika kyçe: standardizimi dhe kontekstualizimi i pyetësorëve brenda Busulla-s; ridizajnimi i platformës duke mundësuar mbështetje për planifikimin e karrierës tek nxënësit..
- DKA duhet të shtojë staf të kualifikuar për orientim në karrierë me fokus në përfshirjen e këshilltareve të karrierës në secilën shkollë.
- Nevoja për përcaktim të qartë të rolit të të gjithë akterëve/palëve mbështetëse (këshilltarë të karrierës, mësues, psikologë shkollorë, pedagogë, anëtarë të klubit të karrierës, prindër, bashkëmoshatarë) brenda dhe jashtë shkollës në përputhje me komponentët e karrierës (zhvillimi i karrierës, edukimi në karrierë, këshillimi për karrierë, orientimi në karrierë, vendimmarrja në karrierë).
- Koordinimi dhe monitorimi i punës së të gjithë akterëve/palëve mbështetëse për të ndërtuar një bazë të vlefshme dhe të nevojshme për orientimin e nxënësve në karrierë.
- Krijimi i një forumi ndër-institucional (MASHTI, MFPT, MKRS, OJQ, Sektori privat, donatorët, etj.) në nivel kombëtar për orientim në karrierë që do të koordinonte aktivitetet e të gjithë akterëve të përfshirë në Fushën e orientimit në karrierë.

Koncepti i orientimit në karrierë bazuar në "Modelin e Pesë Hapave"

Koncepti i orientimit në karrierë ka rezultuar nga studimet e kryera si pjesë e projektit të GIZ-it "Fit for Jobs" dhe intervistat e kryera për këtë segment. Rekomandimet dhe rezultatet e nxjerra theksojnë rëndësinë e orientimit në karrierë dhe përshtatshmërinë e "Modelit të Pesë Hapave", me kusht që të bëhen përshtatjet e duhura dhe të krijohen mundësi zbatimi.

"Modeli i pesë hapave" u zhvillua fillimisht për sistemin arsimor austriak dhe është në përdorim me modifikime që nga viti 1999. Një nga krijuesit e këtij modeli të orientimit në karrierë, Dr. Erwin Kämmerer, ishte konsulenti kryesor në një Projekt të GIZ "Tranzicioni i të rinjve në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor". Gjatë kohës së zbatimit (2009-2011), Dr. Kämmerer ndihmoi përfaqësuesit e katër vendeve nga Ballkani Perëndimor për të përshtatur modelin me kërkesat e secilit prej sistemeve të tyre arsimore. Bazuar në punëtoritë ekzistuese nga Austria, pjesëmarrësit e projektit përzgjedhën dhe përshtatën mënyrën e punës me nxënësit në "Modelin e Pesë Hapave" në secilin shtet. Pjesëmarrësi gjithashtu zhvilloi mënyra të reja ndërvepruese dhe të orientuara drejt veprimit për të zbatuar mësimet përkatëse.

Si një nga rezultatet e projektit të lartpërmendur, fazat e modelit u inkorporuan në modulin "Jeta dhe puna" për nxënësit në Kosovë: (1) Vetëdijesimi; (2) Informacion mbi profesionet; (3) Rrugët e karrierës; (4) Takimet reale; (5) Vendimi për zgjedhjen e profesionit; Në kuadër të programit ekziston Manuali i Trajnimit të Trajnerëve i dedikuar për trajnimin e mësimdhënësve të orientimit profesional, bashkëpunëtorëve ekspertë dhe instruktorëve të rinj. Manualët e zhvilluara për shkollat e mesme të ulëta dhe zyrat e rinisë janë të destinuara për mësimdhënësit e orientimit profesional dhe instruktorët e të rinjve për punë të drejtpërdrejtë me të rinjtë dhe mund të përshtaten lehtësisht me nevojat aktuale të mësimdhënësve dhe nxënësve. Projekti synon që nxënësit dhe të rinjtë të ndjekin rrugën e tyre të vendimmarrjes për shkollën dhe profesionin. Materialet janë zhvilluar në përputhje me nevojat dhe karakteristikat specifike të komunikimit me të rinjtë, si në kontekstin shkollor ashtu edhe jashtëshkollor.

Modeli përmban të gjithë elementët e rëndësishëm të orientimit në karrierë: vetëdijesimin, informacionin për profesionin, opsionet e karrierës dhe shkollës, takime reale dhe njohuri të para në botën e punës, të gjitha në bazë të rezultateve disavjeçare që kanë të bëjnë me procesin e karrierës dhe një vendim i bazuar mirë për rrugën individuale. Gjatë gjithë procesit, të rinjtë nuk duhet t'i përkushtohen ekskluzivisht një profesioni, por në radhë të parë të njohin pikat e forta dhe preferencat e tyre bazuar në punëtori eksperimentale të orientuara drejt veprimit.

Përmbledhje

Koncepti i orientimit në karrierë do të ndërpritet nga klasa e gjashtë në klasën e nëntë në shkollën e mesme të ulët sipas qasjes “Modeli me Pesë Hapa.” Rekomandimi përkatës për këtë vjen nga Studimi Bazë i GIZ-it “Fit for Jobs” (2022): “Shërbimet e orientimit në karrierë rekomandohen t’u ofrohen nxënësve nga klasa e gjashtë, në mënyrë që ata të kenë kohë të mjaftueshme për të eksploruar dhe mbledhur informacion mbi mundësitë që i kanë në dispozicion.” Në të njëjtin studim, të gjithë pjesëmarrësit dëshmojnë se puna në orientim në karrierë në nivelin e mesëm të ulët nuk mjafton dhe ndodh shumë vonë për t’i përgatitur nxënësit për vendimin e ardhshëm: “Stafi i shkollave pilot deklaroi se puna me nxënësit për orientimin në karrierë fillon vetëm në klasën e nëntë dhe mendojnë se kjo kohë nuk është e mjaftueshme për t’i përgatitur nxënësit për orientimin e tyre në karrierë.”

Pesë fazat e modelit duhet të zbatohen përmes aktiviteteve ndërkurrikulare të koordinuara nga këshilltari i karrierës, ku vëmendje duhet t’i kushtohet integritit të balancuar të lëndëve në procesin e orientimit në karrierë, të përshtatshme për zbatim. Do të thotë që mësimmshënësi mund të zhvillojë temë nga lënda e tij në të njëjtën kohë duke punuar me klasën për orientimin në karrierë. Është e rëndësishme t’i lidhni temat lëndore me punëtori të përshtatshme të orientuara në veprime dhe ta drejtoni atë në drejtimin e orientimit në karrierë. Kjo nuk do të jetë e mundur për të gjithë numrin e rekomanduar të orëve të orientimit në karrierë, por është i zbatueshëm në kombinim me numrin ekzistues të orëve në modulin “Jeta dhe Puna.” Për shembull: Në klasën e gjashtë nxënësit mund të punojnë gjatë një prej orëve të historisë në hapin e dytë “Informacion rreth profesionit” dhe ta krijojnë një prezantim/tabelë për botën moderne të punës.

Në klasën e gjashtë dhe të shtatë fokusi do të jetë në punëtoritë për vetë ndërgjegjësim/ vetë njohje, edhe pse edhe punëtoritë për hapat e mbetur do të mbahen, por në një numër më të vogël orësh. Mbajtja e punëtorive përmes këshilltarit të karrierës duhet të ketë karakteristika të mësimmshënies së orientuar në veprim, duke pasur nxënësin në qendër. Krahas punës në ciklin e dy viteve shkollorë, duhet të zbatohen të pesë fazat e “Modelit me Pesë Hapa.” Në klasën e tetë dhe të nëntë të shkollës së mesme të ulët do të përsëriten pesë fazat, duke pasur në fokus takimet reale dhe vendimin përfundimtar. Takimet reale deri më tani janë kufizuar kryesisht në vizitat në shkollat e mesme, të cilat nuk ofrojnë përvojë dhe informacion të mjaftueshëm për nxënësit. Gjatë pushimeve verore dhe dimërore, të organizuar dhe monitoruar nga këshilltari i karrierës, nxënësit nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë mund të kryejnë praktikë disa javore bazuar në rezultatet e aktiviteteve të kryera deri në atë pikë në kuadër të orientimit në karrierë. Në klasën e nëntë nxënësit duhet ta ndjekin modulin e orientimit në karrierë. Me qëllim që orientimi në karrierë të mbulohet në mënyrën e drejtë, duhet gjetur një modalitet për t’u siguruar që orët për edukim në karrierë të mbahen sipas kurrikulës.

Hapat e veçantë të “Modelit me Pesë Hapa”

